

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

Përshëndetje!

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Jemi duke diskutuar për buxhetin e vitit 2023 dhe natyrshëm lind pyetja nëse ky buxhet do të ketë në fokus shqiptarët, konsumatorët, familjet e këtij vendi dhe a do t'i përmbushë pritshmëritë e shqiptarëve. Në fakt, e kundërta është më e mundur të ndodhë, pasi ky buxhet pritet të rëndojë akoma edhe më shumë mbi xhepat e shqiptarëve, në kuletën e çdo familjeje, e çdo konsumatori, duke shtuar vlerat e tij, siç e kërkon tradita, në të njëjtën kohë, duke mos u përgjigjur nevojave të krizës së çmimeve dhe të inflacionit që po jetojmë.

Rreth 2 miliardë lekë më shumë do të hyjnë në buxhetin e vitit 2023 nga taksimi i profesioneve të lira. Mjekët, dentistët, avokatët duhet të paguajnë më shumë për të rritur buxhetin e vitit që vjen. Në vitin 2023 do të mbliidhen 130 milionë euro më shumë nga taksat e shqiptarëve, më shumë para nga TVSH-ja e produkteve të shtrenjtuara, të cilat në vitin që po lëmë pas kaluan edhe parashikimet e korrigjuara të Ministrisë së Financave, duke kaluar 500 milionë euro për vitin 2022.

Nga sa më sipër, në vitin 2023 parashikohen vetëm 12 miliardë lekë mbështetje për energjinë elektrike, e cila, pa dyshim, ka rëndësinë e saj, por është një pjesë e vogël, e cila, në fakt, nuk mund të mbushë vështirësinë që hasin shqiptarët.

Nuk ka asnjë paketë ndihme reale për qytetarët dhe asnjë masë për të përballuar inflacionin e rritur.

Ky buxhet i ka lënë në harresë totale pensionistët, të cilëve, siç më pohoi njëri prej tyre para disa ditësh, vitin që po vjen mund t'u mungojë një filxhan kafe ose një gotë me qumësht të ngrohtë.

Për profesionistët dhe punonjësit e sektorit shtetëror nuk është planifikuar asnjë rritje pagash për vitin 2023. Për mjekët dhe infermierët planifikohet rritje 6% e pagave, më pak se gjysma e inflacionit në treg.

Familjet me ndihmë ekonomike do të tkurren në numër. Nga 67 mijë planifikohet që numri i personave që përfitojnë ndihmë ekonomike të shkojë 64 mijë, kurse vlera mesatare e saj do të zvogëlohet.

Arka e shtetit do të vazhdojë të mbushet, por të vetmet shpenzime që nuk do të tkurren vitin që vjen, përkundrazi, do të rigjallërohen, janë ato për koncesionet dhe PPP-të, të cilat do të vazhdojnë të marrin pagesa të majme nga arka e shtetit dhe do të vazhdojnë të thithin taksat e shqiptarëve.

Gjithashtu, do të vazhdojnë pagesat për koncesionin e dështuar të laboratorëve, me kosto edhe më të rritur për vitin 2023. Ky koncesion i la pacientët rrugëve vitin që po lëmë pas, por le të shpresojmë që vitin që vjen, duke qenë se do të rrisë përfitimet që do të marrë nga buxheti i shtetit, të ndodhë një mrekulli dhe të plotësojë detyrimet e tij ndaj pacientëve në spitalet shqiptare. Koncesionet e check up-it dhe sterilizimit do të vazhdojnë të marrin copa të majme nga buxheti, edhe pse të denoncuara edhe nga KLSH-ja si akte të pastra korruptive.

Për sa i përket bujqësisë, tashmë fermerët e kanë humbur shpresën, sepse janë totalisht të zhveshur nga çdolloj ndihme. Propaganda e bukur i shfrytëzon për poza dhe pastaj i braktis me tregje të tejmbushura, me naftën e shtrenjtë dhe me çmime imputesh së paku të trefishuara vitet e fundit.

Ky buxhet planifikon rreth 1,32 miliardë lekë për naftën në vitin 2023, ndërkohë që edhe viti që po lëmë pas kishte një shifër të ngjashme, rreth 14 milionë dollarë shkuan për subvencionin e naftës. Mbi 15 mijë fermerë, e pohuar kjo edhe nga ministrja e Bujqësisë, nuk kanë përfituar asnjë litër naftë të subvencionuar.

Sipas INSTAT-it, ritmet e rritjes së sektorit të bujqësisë për vitin 2021 ishin më të ulëtat në 24 vjetët e fundit. Sipas Organizatës së Ushqimit të Kombeve të Bashkuara, FAO, mbështetja për fermerët në Shqipëri është rreth 18 herë më e vogël sesa ajo në rajon. Sipas analizës së bërë, një fermer shqiptar merr mesatarisht 3 euro financim direkt për hektar, ndërkohë që 42 euro për hektar shkojnë në institucione dhe entet monitoruese të bujqësisë në Shqipëri. Ndërkohë, në çdo vend tjetër të rajonit, nëse do të bëjmë krahasimin, pjesa më e madhe e subvencionit shkon si mbështetje direkte për fermerin.

Shkurtimisht, Bosnja jep mesatarisht 66 euro për hektar, nga të cilat 60 euro shkojnë si mbështetje direkte për fermerin, kurse Kosova jep 69 euro mbështetje direkte për fermerin. Ndërkohë, në vendet e Bashkimit Europian, drejt të cilave aspirojmë të shkojmë, nga 446 euro për hektar në total, 274 euro jepen si mbështetje direkte për fermerët. Pra, në konkluzion fermeri shqiptar, me të cilin

propagandohet kaq shumë, subvencionohet rreth 100 herë më pak se mesatarja e vendeve të Bashkimit European, ndërkohë që ne presim konkurrueshmëri të produkteve bujqësorë.

Përveçse është e nën mbështetur si sektor, një pjesë të madhe të fondeve që bujqësia thith nga buxheti i shtetit, nuk i shkojnë fermerit, nuk shkojnë në destinacion, por shkojnë në menaxhim, në paga dhe më e keqja, shkojnë në korrupsion.

Në kushtet e zbrazjes masive të fshatit, mbështetja për bujqësinë duhet të ishte prioritet. Realiteti nuk është aspak i mirë, por, me sa duket, kur vjen puna për mbështetje nga buxheti, asgjë nuk mund t'i konkurrojë klientët e qeverisë në të qenit të vetmit të privilegjuar për vitin 2023.

Në konkluzion, buxheti që na është paraqitur, është projektuar pa asnjë konsideratë të krizës së inflacionit ku po jetojnë shqiptarët, është një buxhet që u jep prioritet PPP-ve dhe koncesioneve në drejtim të transfertës së taksave të shqiptarëve aty, por pa pasur asnjë mekanizëm kontrolli ndaj koncesionarëve, është një buxhet më i varfër për shqiptarët sesa një vit më parë.

Faleminderit!